

VENDIM
Nr. 105, datë 3.4.2013

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ALDO 03”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 30, datë 1.2.2013 Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Shoqëria “Aldo 03” sh.p.k. është licencuar nga KKRT-ja, me vendimin nr. 171, datë 3.9.2003, si operator radiofonik privat vendor në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për radion private vendore “Radio Aldo 03”. Me vendimet nr. 658, datë 18.12.2007 dhe nr. 246, datë 3.10.2011, KKRT-ja ka rinovuar licencën për këtë subjekt; ndërsa me vendimin nr. 30, datë 1.2.2013, KKRT-ja ka filluar procedurën për pavlefshmërinë e licencës për subjektin “Radio Aldo 03”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 3.9.2012.

Në përputhje me ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizive”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së dhe urdhrit nr. 45, nr. 179 prot., datë 20.3.2013, të ndryshuar të kryetarit të KKRT-së, më datë 1.4.2013, komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit u mblodh për të shqyrtuar, ndër të tjera, edhe aplikimin për rinovimin e licencës për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.

Bazuar në pikën 2.2 paragrafi C të rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizive”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”, komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit nuk realizoi shqyrtimin paraprak dhe tërësor të aplikimit për këtë subjekt, pasi “Radio Aldo 03” nuk kishte shlyer detyrimet financiare për periudhën e vlefshmërisë së licencës në shumën 177.400 lekë, duke vendosur skualifikimin e tij.

Neni 33, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

5. kërkuesi...nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

Nga ana tjetër, me vendimin nr. 30, datë 1.2.2013, KKRT-ja ka filluar procedurën për pavlefshmërinë e licencës për subjektin “Radio Aldo 03”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 30, datë 1.2.2013,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.
 2. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 047/FML të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30-ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati